



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 744/6 prot.

Tiranë, më 14.10.2025

V E N D I M

Nr. 235, datë 14. 10. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 110 Regj, datë 07.05.2025, të paraqitur nga ankuesit z. A.M dhe S.M, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 1920 rep dhe nr.642 kol, datë 03.03.2025 nga Av.A. D, me Licensë Nr. 12879, kundër Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njesisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *“racës”*, *“gjendjes arsimore”*, *“moshës”*, *“gjendjes ekonomike”* dhe *“aftësive digjitale”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese parashtron ndër të tjera se:

A.M (49 vjeç) dhe S.M (44 vjeçe) janë të martuar dhe u përkasin komunitetit rom. Ata kanë lindur dhe banojnë në Tiranë. Asnjë nga të dy nuk ka ndjekur shkollën qoftë edhe atë fillore, ndaj për këtë arsye ata nuk kanë mësuar kurrë të lexojnë dhe as të shkruajnë. Gjatë gjithë jetës janë përballur me vështirësi për të gjetur punë dhe kanë qenë të detyruar të shfrytëzojnë çdo mundësi për të siguruar të ardhura për mbijetesë. Aktualisht, ata janë të punësuar në një treg me rroba të përdorura, një punë kjo me kohë të pjesshme 4 orë në ditë, me një pagë e cila nuk mbulon nevojat e tyre bazë si qiraja, ushqimi, veshmbathjet dhe shpenzimet e tjera jetësore.

¹ Në vijim do t'i referohemi Komisioneri.

Në këto kushte, ankuesit vendosën të aplikojnë për ndihmë ekonomike duke qenë se plotësojnë kriteret për përfitim. Më datë 03.03.2025, ata janë paraqitur pranë Njesisë Administrative Nr.5 ku banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike si institucioni publik përkatës që trajton këto kërkesa. Punonjësja e Njesisë Administrative, iu kërkoi të dorëzonin dokumentacionin e mëposhtëm :

- a) Certifikatë familjare;
- b) Vërtetim pronësie nga ASHK
- c) Vërtetim pune.

Dokumente këto të cilat parashikohen në VKM nr.597, datë 04.09.2019 “*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike*”.

Për të siguruar këto dokumente, ishte i nevojshëm përdorimi i portalit *e-albania*, por ankuesit nuk dispononin një llogari në këtë platformë dhe për shkak të mungesës së njohurive në të lexuar dhe në të shkruar, nuk ishin në gjendje as të kuptonin dhe as të përdornin platformën. Pavarësisht dijenisë për këtë fakt, pranë Njesisë Administrative nr.5, nuk iu ofrua asnjë ndihmë për të realizuar aplikimin, por u mjaftuan në dhënien e përgjigjes standarde: “Herën tjetër sillni dokumentet për të kryer aplikimin”.

Fillimisht ankuesit kanë bërë përpjekje për të marrë certifikatën familjare fizikisht pranë Zyrës së Gjendjes Civile, por u është komunikuar se shërbimet e kësaj zyre jepen vetëm elektronikisht. I është kërkuar Njesisë Bashkiake nxjerrja nga sistemi i tyre i certifikatës familjare që i kërkohet, si organ që ka në varësi dhe gjendjen civile, por nuk është asistuar sepse shërbimet merren vetëm elektronikisht. Ky ankim i drejtohet edhe Zyrës së Gjendjes Civile, e cila është strukturë/organ administrativ që organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen civile”, i ndryshuar. Kjo zyrë është në varësi dyfishe, të Njesisë Bashkiake dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (neni 61 dhe 64 i ligjit nr.10129/2009)

Referuar vërtetimit të pronës, ankuesit janë paraqitur fillimisht pranë ASHK-së dhe kanë kërkuar vënien në dispozicion të vërtetimit, por u është komunikuar se shërbimi merrej vetëm elektronikisht, me vulë digjitale.

Vetëm përmes ndihmës së avokatëve, ankuesit nëpërmjet komunikimeve elektronike me *hepldesk* (të bashkëngjitura si prova me ankimin) mundën të hapnin llogarinë në *e-albania*. Kjo procedura ka marrë kohën e saj (rreth një javë) dhe duke marrë parasysh që të dy janë në pamundësi për përdorimin e pajisjeve digjitale/teknologjike, asistimi ka qenë i nevojshëm për të dy. Ky hap ka qenë i detyrueshëm për të nxjerrë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për ndihmë ekonomike konkretisht, për të nxjerrë certifikatën familjare, vërtetim page, vërtetimin për pronësi dhe vërtetimin negativ pensioni për ankuesit.

Në datën 3 mars 2025 është kryer aplikimi për vërtetim pronësie online ku pagesa e shërbimit është kryer me postë dhe fatura është bashkëngjitur në platformë. Që prej kësaj date e deri më sot ky shërbim nuk është marrë nga ankuesit pa patur ndonjë përgjigje të argumentuar.

Koha e humbur nga vajtje ardhjet nëpër sportele pa u ndihmuar për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe vështirësive në aksesimin e dokumentacionit të kërkuar, bëri që ankuesit të mos përfundonin në kohën e duhur. Kjo vonesë çoi në humbjen e mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike në muajin mars.

Njësia Administrative nr.5 si organ kompetent për trajtimin e aplikimeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, ushtron një funksion me natyrë të dyfishtë në ofrimin e këtij shërbimi. Në fazën fillestare aplikimi realizohet fizikisht nga individët përmes paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar dhe të nxjerrë elektronikisht, i cili më pas përpunohet dhe hidhet në sistem në mënyrë elektronike nga administrata përkatëse. Ndërkohë, faza e mëtejshme e ndjekjes së statusit të aplikimit, komunikimet e tjera si dhe marrja e përgjigjes për pranimin ose refuzimin e tij mundësohet vetëm nëpërmjet platformës elektronike *e-albania*. Kjo mënyrë e organizimit të procesit krijon ndarje funksionale mes aplikimit fizik dhe aksesit elektronik ndaj informacionit dhe përgjigjeve, çka përbën një barrierë reale për individët që nuk kanë aftësi digjitale apo akses në pajisje teknologjike.

Ankuesit kërkojnë nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njesisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, për shkak të racës, gjendjes arsimore, moshës, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale. Detyrimin e Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njesisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë që të merren masa për të siguruar mjetet dhe mënyrën e ofrimit të asistencës dhe ndihmës për të gjithë personat, të cilët nuk mund të marri vetë dhe në mënyrë të pavarur shërbimet *on-line* nëpërmjet *e-albania*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*racës*”, “*gjendjes arsimore*”, “*moshës*” dhe “*gjendjes ekonomike*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual,*

karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Me shkresën nr.744/1 prot., datë 22.05.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, pranë Njësisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Në lidhje me ankesën është vendosur në dijeni nëpërmjet të njëjtës shkresë edhe Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

2. Me shkresën nr. 1755/1 prot., datë 30.05.2025, të Administratorit të Njesisë Administrative Nr.5, Bashkia Tiranë, Zyra e Gjendjes Civile, pranë kësaj njësie administrative, ka depozituar parashtrimet e mëposhtme:

Z. A. apo S.M nuk janë paraqitur asnjëherë pranë Zyrës së Gjendjes Civile për t'i ndihmuar në marrjen e shërbimit. Për sa i përket ndihmës kundrejt qytetarit për përdorimin e portalit *e-albania* nuk është kompetencë e Njesisë Administrative, ky shërbim por vetëm e institucionit përkatës.

3. Nëpërmjet *emailit* të datës 12.06.2025, Av.A.D, përfaqësuese me prokurë e ankuesve, ka depozituar prapësimet e saj, duke parashtruar:

Në përgjigjen e dhënë nuk është paraqitur asnjë provë konkrete, por vetëm një deklaram i thjeshtë nga ana e institucionit. Në mënyrë të tërthortë, në fjalinë e dytë të kundërshtimeve të saj, Zyra nënkupton mungesën e një strukture fizike për ofrimin e asistencës ndaj qytetarëve. Kjo do të thotë se, sipas deklaramit të vetë institucionit, nuk është në përgjegjësinë e saj asistenca për qytetarët që hasin vështirësi në përdorimin e shërbimeve digjitale që lidhen me shërbimet që ofrohen prej saj.

Në këto kushte, vetë institucioni nënkupton se nuk është në pozita për të pasur dijeni apo për të qenë i informuar mbi qytetarët që mund të paraqiten fizikisht pranë ambienteve të tij apo që kërkojnë ndihmë digjitale. Kjo përforcon qëndrimin tonë se ka një mungesë reale të mekanizmave funksionale për asistencë, çka e bën edhe më të dukshme mungesën e aksesit efektiv të ankuesëve ndaj shërbimeve publike pranë kësaj zyre.

4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 744/4 prot, datë 01.07.2025, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 15.07.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 15.07.2025, në mungesë të ankuesve dhe përfaqësueses me prokurë të posaçme, ndërsa morën pjesë: znj.R.K, Përgjegjëse e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative nr. 5, Bashkia Tiranë dhe znj. A.K, Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social, Njësia Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, sipas autorizimit nr.2478 prot., datë 15.07.2025, të lëshuar nga Administratori i Njesisë Administrative Nr.5, Bashkia Tiranë, si dhe z. I. S dhe z.A. S, specialist në Drejtorinë e Metodologjisë dhe Unifikimit të Shërbimit, sipas autorizimit nr.1799/1 prot datë 15.07.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.

Bazuar në aktet e administruara dhe pohimet e palëve gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës rezultoi se:

Ankuesi A.M, i datëlindjes 07.07.1976 dhe ankuesja S.M, e datëlindjes 04.10.1981, janë bashkëshortë dhe banojnë në Njësinë Administrative Nr.5, në Bashkinë Tiranë.

Më datë 03.03.2025, ankuesit deklarojnë se janë paraqitur pranë Njesisë Administrative Nr.5 ku banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike. Punonjësja e Njesisë Administrative, iu kërkoi të dorëzonin dokumentacionin që kërkohet për të përfituar ndihmën ekonomike sipas përcaktimeve në VKM nr.597, datë 04.09.2019 *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*, ku ndër të tjera përfshihet edhe certifikata familjare.

Për të siguruar këto dokumente që kërkohen për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike, përfshi certifikatën familjare, është i nevojshëm përdorimi i portalit *e-albania*.

Ankuesit nuk dispononin një llogari në këtë platformë dhe për shkak të mungesës së njohurive në të lexuar dhe në të shkruar, nuk ishin në gjendje të përdornin platformën. Pavarësisht dijenisë për këtë fakt, ankuesit pretendojnë se pranë Njesisë Administrative nr.5, nuk iu ofrua asnjë ndihmë për të realizuar aplikimin, por u mjaftuan në dhënien e përgjigjes standarde: *“Herën tjetër sillni dokumentet për të kryer aplikimin”*.

Ankuesit deklarojnë se, fillimisht kanë bërë përpjekje për të marrë certifikatën familjare fizikisht pranë Zyrës së Gjendjes Civile, por u është komunikuar se shërbimet e kësaj zyre jepen vetëm elektronikisht. Ata deklarojnë gjithashtu se, i kanë kërkuar Njesisë Bashkiake Nr.5, Bashkia Tiranë, nxjerrjen nga sistemi i tyre i certifikatës familjare që i kërkohet, si organ që ka në varësi dhe gjendjen civile, por nuk janë asistuar me argumentin se shërbimet merren vetëm elektronikisht.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, si nëpërmjet komunikimit shkresor (shkresa nr.1755/1 prot., datë 30.05.2025) ashtu edhe sipas deklarimeve në seancë dëgjimore, Zyra e Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative nr.5, Tiranë, e kundërshtoi si të pavërtetë pretendimin e palës ankuese, se ata kishin bërë përpjekje për të marrë certifikatën familjare fizikisht pranë kësaj zyre, duke deklaruar se ankuesit nuk ishin paraqitur asnjëherë pranë kësaj zyre për të ndihmuar për marrjen e shërbimit, certifikatës familjare.

Ankuesit deklarojnë se, vetëm përmes ndihmës së avokatëve, nëpërmjet komunikimeve elektronike me *hepldesk* mundën të hapnin llogarinë në *e-albania*. Kjo procedurë sipas tyre ka

marrë kohën e saj (rreth një javë) dhe duke marrë parasysh që të dy janë në pamundësi për përdorimin e pajisjeve digjitale/teknologjike, asistimi ka qenë i nevojshëm për të dy. Ky hap ka qenë i detyrueshëm për të nxjerrë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për ndihmë ekonomike konkretisht, për të nxjerrë edhe certifikatën familjare.

Koha e humbur nga vajtje ardhjet nëpër sportele pa u ndihmuar për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe vështirësive në aksesimin e dokumentacionit të kërkuar, bëri që ankuesit të mos përfundonin në kohën e duhur. Kjo vonesë çoi në humbjen e mundësisë për të aplikuar për ndihmë ekonomike në muajin mars 2025.

Ankuesit i janë drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi, duke kërkuar konstatimin e diskriminimit nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njesisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë, për shkak të racës, gjendjes arsimore, moshës, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale.

Komisioneri evidenton se, objekt i ankesës në shqyrtim janë vetëm pretendimet kundër Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative Nr.5, Bashkia Tiranë, që lidhen me ofrimin e shërbimit të gjendjes civile nga ana e këtij subjekti, konkretisht lëshimin e certifikatës familjare, si një nga dokumentat e nevojshëm për të kryer aplikimin për të përfutur ndihmën ekonomike.

Sipas ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen civile”, i ndryshuar, shërbimi i gjendjes civile, është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson dhe përditëson Regjistrin Kombëtar, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi. (neni 60, i ligjit).

Në rastin objekt shqyrtimi ky shërbim ofrohet si funksion i deleguar nga organet e qeverisjes vendore, konkretisht nga Zyra e Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative Nr.5, në Bashkinë Tiranë, ku ankuesit pretendojnë se janë paraqitur për të marrë fizikisht shërbimin, certifikatën familjare, por nuk janë ndihmuar nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, që të marrin online nëpërmjet portalit e-albania shërbimin e kërkuar.

Referuar ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen civile”, i ndryshuar, Zyra e Gjendjes Civile, ka varësi dyfishe, nga Njësia Administrative nr.5, Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile dhe të gjitha udhëzimet/orientimet tekniko-ligjor për Zyrat e Gjendjes Civile, vijnë nga ky institucion. Ndërsa emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile dhe largimi i tij nga detyra bëhet nga kryetari i bashkisë, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe me miratimin e kësaj të fundit.

Ankuesit pretendojnë se, me datë 03.03.2025, janë paraqitur pranë Njesisë Administrative nr. 5, Tiranë, ku ata banojnë, për të aplikuar për ndihmë ekonomike dhe pasi i'u është kërkuar të dorëzonin dokumentacionin respektiv, ku përfshihet edhe certifikata familjare, i janë drejtuar fizikisht edhe Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative Nr.5, por nuk janë ndihmuar për të nxjerrë certifikatën familjare. Më pas, ankuesit deklarojnë se vetëm përmes ndihmës së avokatëve, nëpërmjet komunikimeve elektronike me helpdesk kanë mundur të hapnin llogarinë në e-albania, nëpërmjet të cilës më pas janë pajisur me certifikatën familjare.

Referuar komunikimeve me *e-mail* që janë reaziluar me adresën: *helpdesk@e-albania.al*, adresë nëpërmjet të cilës komunikohet me portalin e-albania, konstatohet se, të dy ankuesit kanë komunikuar me këtë adresë *e-maili* më datë 13.02.2025 dhe 18.02.2025, për t'u asistuar në hapjen e llogarisë në *e-albania*. Referuar dokumentit certifikatë familjare, e depozituar nga ankuesit, konstatohet se më datë 19.02.2025, ankuesit janë pajisur me këtë dokument, i cili figuron të jetë lëshuar *on-line* nëpërmjet portalit *e-albania* dhe vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Sa më sipër dhe bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankeses, rezulton se, këto pretendime të ankuesve nuk rezultojnë të bazuara. Sipas provave të sipërcituara rezulton e provuar se, më datë 03.03.2025 kur ankuesit pretendojnë se janë paraqitur pranë Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake Nr.5, Bashkisë Tiranë dhe nga ana e kësaj të fundit nuk janë ndihmuar/asistuar për tu pajisur me certifikatë familjare, ata kanë qenë të pajisur me certifikatë familjare, e cila rezulton të jetë lëshuar elektronikisht më datë 19.02.2025.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi, në kushtet kur nuk provohet fakti i pretenduar prej ankuesve, se më datë 03.03.2025 janë paraqitur pranë Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative Nr.5, Bashkia Tiranë, Komisioneri vlerëson se nuk mund të vlerësohet dhe analizohet në mënyrë hipotetike në lidhje me sjelljen e Zyrës së Gjendjes Civile.

Përfundimisht, bazuar në sa më sipër është arsyetuar, Komisioneri vlerëson se, ankuesit nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative Nr. 5, Bashkia Tiranë. Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative Nr. 5, Bashkia Tiranë, ardhur për shkaqet e pretenduara dhe për rrjedhojë nuk konstatohen shkelje të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të *“racës, moshës, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike dhe aftësive digjitale”*, të ankuesve A.M dhe S.M, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Administrative nr.5, Bashkia Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Raca, gjendja arsimore, mosha, gjendja ekonomike dhe aftësitë digjitale
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit : Mosdiskriminim